

KOSOVA

Ballina: Shpresa Osmani
Foto: Admir Sahiti

**Ai që më
propozoi
për deputet
ma zuri
vendin vetë**

*Ç'fat patën
miset më të
bukura
shqiptare*


**Dreqi më qoi
e mora burrin
profesor e jo
naj politikan**

*Këngëtarët tona
që u martuan
16 vjeçe*

**Pse dashurohem
vetëm në burra
të martuar**

SHPRESA OSMANI

*e pa konkurrencë në
profesionalizëm e biznes*



Qeramike

Hotel

Ndërtim

Beton

Gurthyes



✉ info@dino-company.com

☎ +383 44 206 685

🌐 +381 35 566 666

I bëra 80 vjet pa asnjë gëzim në jetë!

Në vitet 60 ia mësyva kurbetit, sepse sofa jonë në atë kohë ishte pa bukë. Punova çka më ofrohej... Madje edhe pas-trues i nevojtove, vetëm e vetëm që të tuboja paka para që t'ua dërgoja në familje, që të mos vuanin për kafshatë goje...

Kur, shyqyr Zotit, Kosova u çlirua më 1999, isha ndër të parët që u ktheva në Kosovë, sepse më kishte marrë malli edhe për therrat e katundit, e lëre më për familjen, farefisën e katundarët e mi, që 40 vjet nuk i kisha parë.

TË DALTË FLAKA SHQIPËRI!

Dhe, po ato ditë pas lufte, tre shokë të mi më morën me vete me një veturë të vjetër, që e kishim pasur edhe para lufte dhe ia mësymë Shqipërisë. Por, posa hymë në kufi - çka me pa: shkret në të gjitha anët...

Sidoqoftë, ëndrra ime që ta shihja Shqipërinë po realizohej, por të rrëqethej trupi nga ato pamje të tmerrshme, nga ai mjerim, nga ajo skamje...

E kaluam Kukësin dhe hajt bir - sa prej një kodre në tjetrën, prej një

bregu në tjetrin, prej një lumi në tjetrin... Sa teposhtë e sa përpjetë... Trupi të rrëqethej nga ato pamje trishtuese, nga ato pamje që ta shtinin tmerrin...

Në një moment, i zhgënjyer tej mase nga ajo që shihja, e që nuk e kisha pritur, thash: "Sa shumë të kam dashtë oj Shipni, e flaka të daltë në të tana anët!"

BABAI IM VDIQ ME SY HAPUR...

Babai im, rahmet i pastë shpirti, sa isha i ri, ende pa dal në kurbet, shumë më pat folur për Shqipërinë. E donte shumë...

Ai mbante lidhje me disa burra në Prizren, prej nga shiheshin edhe malet e Shqipërisë. Njëri prej tyre kishte qenë nga një fshat në kufi, nga Vërmica.

Aso kohe isha i ri dhe nuk i kuptoja mirë qëllimet e tyre, por e dija se

para nesh ishte një rrugë e gjatë. Flitej për një shtet aq të ndaluar, sa unë, edhe pse shumë i ri, e kuptoja se nuk duhej pyetur pse nuk mund të shkohet në Shqipëri.

Tash e shumë vjet babai im më nuk është në jetë, ashtu sikur nuk janë në jetë as shumë e shumë patriotë shqiptarë që u dergjën nëpër burgjet e Serbisë, me në krye Adem Demaçin.

Tash, ndoshta, kur Kosova është çliruar definitivisht dhe është shtet i pavarur, shumëkush mund të gëzohet, por jo edhe unë, se kam shumë plagë në zemër. Ende një pjesë e madhe e popullit tim jetën në skamje e varfëri, kurse disa të tjerë, që dikur nuk ishin askush, tash bëjnë jetë luksi dhe nuk ia dinë fundin pasurisë...

Sidoqoftë, ka momente kur nuk di të shprehem mirë, e lotët më dalin kur më mungojnë fjalët e duhura...

Ajet L.

E faqes së parë

Shpresa Osmani

*e pa konkurrencë
në profesionalizëm e biznes*

Shpresa Osmani është e zonja, profesionale dhe nga ato shqiptare që ia kanë dalë suksesshëm e bindshëm që t'i realizojnë ëndrrat e veta edhe jashtë Kosovës. Në botën e të bukurës, në "Beauty Center Shpresa", ëndrrat e femrave për një pamje të përsosur bëhen përditë realitet. Shpresa thotë se puna e gjatë nuk e lodhë, sepse janë klientet dhe rezultatet pozitive që e motivojnë. Për punën dhe jetën e Shpresa Osmanit, flasim në "Kosovare"...

Shpresë, disa fjalë për veten?

- Jam me prejardhje nga Podujeva, jetoj në Zvicër, ku edhe e kam biznesin tim "Beauty Center Shpresa".

Si ishte fëmijëria jote dhe a kishe ëndrra që të bëheshe kjo që je sot?

- Jam vajza e madhe e familjes. I kam tri motra dhe dy vëllezër. Jemi rritë në një familje të madhe, por nuk na ka munguar asgjë dhe gjithmonë kemi qenë të rrethuar me dashuri. Jam rritur me gjyshër, të cilët përherë më uronin për lumturi e suksese. Urimet e tyre janë realizuar, pasi mua puna më ka ecur mirë e mbarë. Jam munduar e mundohem që familjen time ta bëj krenare.

Si nisi rruga jote në botën e biznesit?

- Jam shkolluar në Oftringen dy vjet dhe e kam kuptuar që mundem me ia dalë më tutje. Andaj, kam vazhduar...

Na flisni pak më shumë për "Beauty Center Shpresa"?

- Është biznes në të cilin kam investuar shumë. Mbi të gjitha, është investuar dashuri dhe profesionalizëm. Në "Beauty Center Shpresa" i bëjmë të gjitha tretmanet kozmetikë. Te ne realizohen të gjitha nga stafi i kualifikuar, profesional dhe korrekt.

Cili është shërbimi më ekskluziv që ofroni në sallon?

- Të gjitha janë shërbime ekskluzive që arrihen me punë delikate, profesionale dhe gjithmonë ndjekur nga teknologjia e përsosur.

Shumë femra janë shkolluar dhe punësuar te ju. A je krenare me të arriturat dhe sukseset e tyre?

- Jam shumë krenare kur një femër ia del të shkollohet, të punojë dhe të arrijë suksese në punë. Bashkëpunëtorët tona janë të tilla, të afta dhe shumë të zonjat. Gëzohem kur edhe koleget arrijnë t'i hapin sallonet e tyre dhe të ecin përpara. Kjo është kënaqësi imja...

Keni edhe produkte me emrin tuaj, mund të na flisni për to?

- Qe dy vjet e kam edhe produktin personal, që është gel për thonj, për të cilin kam pritur dy vjet derisa është vërtetuar kualiteti tij.

Ka ndodhur, ndonjëherë, të lodheni nga puna?

- Është shumë normale që edhe mua të më lodhë puna, sepse ka raste kur punoj 9 deri në 12 orë. Megjithatë, kur shoh se klientet janë të kënaqura, e harroj lodhjen. Madje, them sa shpejt erdhi koha

për ta mbyllur sallonin...

Personi që u motivon?

- Vajza ime, por edhe punëtorët.

Suksesi më i madh që ke përjetuar?

- Para dhjetë vjetësh, kur bëra hapjen e sallonit "SwissNails" në Podujevë, ishte kënaqësia më e madhe në jetën time. Suksese i konsideroj edhe pikat e reja në Podujevë, ku bashkëpunoj me vëllanë Arian Topanicën dhe me motrën Shyhrete Restelicën.

Cila është jeta personale?

- Jam bashkëshorte, nënë. Jetoj me burrë dhe me dy fëmijët e mi, tashmë të rritur: Lelen 20 vjeçe, punon kontabiliste dhe Lonin 17 vjeç, i cili është duke e kryer shkollën për grimer dhe frizer. Në kohën e lirë jemi bashkë dhe bëjmë jetë normale, si gjithë njerëzit në mërgim.

Pa çka ose pa kë nuk mundesh në jetë?

- Pa dyshim, pa fëmijët dhe pa burrin, ku në çdo situatë, qoftë të mirë apo të keqe, kanë qenë pranë meje.

Porosia juaj për femra?

- Mos u ndali! Vazhdoni dhe realizoni ëndrrat e dëshirat tuaja! Punoni me shpirt, me zemër dhe pa hile!

Nderim Neziri



Ah zaman, zaman...



Pse dikur qanim për kurbetçinjtë e tash jo?

Kurbetçinjtë janë kënga dhe vaji i popullit tonë. Ata na kanë mbajtur gjallë ekonomikisht në kohët më të vështira, por edhe tash. Ata e kanë zbutur varfërinë tonë.

Shumica e kurbetçinjve nuk ia mësynë Evropës nga dëshira, por nga zori për bukë dhe jetë më të mirë. Ishte varfëri. Mbaj mend shtëpitë me çati thekre! E, ai që kishte mundësi ta kishte një çati mbuluar me tjegulla ishte i përmendur. Komunikimi ndërmjet djemve që

shkonin në kurbet dhe familjes bëhej me letra. Kur merrnim letër nga vëllai a dikush tjetër, së pari, shikonim datën se kur ishte nisur letra. E, ajo ishte adresuar dhjetë ditë a dy javë më parë. Zakonisht, letra i referohej babait, kryefamiljarit të shtëpisë. Dhe, nëse ndodhte ndryshe, i pari i shtëpisë mund të hidhërohej deri në masën sa të thoshte se kanë ndërruar kohët... Kurbetçinjtë kishin mall për çdo kë në mëhallë, madje edhe për fshatarët e tjerë në fshatin nga ishin.

PLEQ E TË RINJ E RESPEKTONIN KURBETÇARIN

Dhe, populli jo vetëm që i donte, por edhe i respektonte kur ndonjëri kishte fatin të vinte për pushim në Kosovë, që kishte arritur të pajisej me doku-

ment udhëtimi.

Ishte adet i përgjithshëm që kur vinte ndonjë kurbetçinj, të afërmit dhe farefisi ta vizitonin dhe t'i uronin mirëseardhje në familje. Në anën tjetër, ka qenë nderim të respektohej çdo kush që vinte për vizitë. Shtëpisë i shtoheshin mysafirët e jeta në familje bëhej më dinamike. E, kur ktheheshin kah kanë ardhur, bëhej shumë vaj, derdheshin shumë lot...

E, SOT?

Sot është më ndryshe. Vijnë e shkojnë dhe mund të mos e merr vesh as familja e gjerë, e lëre më mëhalla a fshati. Sepse, kohët kanë ndryshuar, kurse ardhja e disa prej tyre është shumë e shpeshtë, sa edhe është vështirë t'i pritje e përcjellje.

S. K.

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Rilinda Krasniqi

Dionita Sadrija

Arta Dreshaj

Dizajni:

Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75**Email:** info@kosovarja-ks.com**Marketing:**

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com


BABI, PSE TI S'JE DEPUTET?

Synimi i popullit shqiptar në Kosovë, shekuj me radhë, ishte të arrihet Pavarësia dhe ai synim u realizua.

Por, për fat të keq, në vend që të investohet nga të gjitha shtresat e qytetarëve dhe strukturave udhëheqëse shtetërore, partiake e komunale në Kosovë, për theelimin dhe forcimin e shtetit, shumë prej nesh i harruam obligimet e premtimet që iu dhanë popullit që 20 vjet radhazi dhe u kthyem në drejtim të interesave personale, familjare dhe farefisnore. Dhe, ata që janë nën dardhë po i hanë dardhat...

Ka ardhur koha që çdo njeri në Kosovë, e që mendon për të mirën e shtetit dhe të kombit, më në fund, të kuptojë drejt, shpejt e seriozisht dhe me vendosmëri nisjen e luftës më të ashpër dhe më të hapur kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe dukurive të tjera negative, të cilat hëpërhë kanë shtrirje shumë të gjerë në të gjitha poret e jetës në Kosovë.

Dukuritë negative në Kosovë rëndë e kanë dëmtuar gjendjen kombëtare në një anë, kurse, në anën tjetër, viteve të fundit, dukshëm është shtuar revolta e më se shtatëdhjetë për qind të qytetarëve të papunë në Kosovë.

Andaj, situata, gjendja çfarë është e po e përjetojmë, na imponon që forcat progresive ndaj të gjithë atyre që u pasuruan dhe po pasurohen në mënyrë të paligjshme dhe në kurriz të popullit, pa

marrë parasysh kush janë dhe nga janë, t'i fillojmë aksionet lidhur me prejardhjen e pasurisë...

Por, goxha një pjesë të madhe të fajit për këto i ka dhe vetë populli, të cilit i mungon strategjia a ndonjë platformë për zgjidhjen e shumë çështjeve me rëndësi kombëtare e historike. Historia s'do na i falë gabimet, të cilat jemi duke i bërë, e të cilat një ditë, në të ardhmen, do t'na kushtojnë shtrenjtë.

Njëri thotë: "Hajde – hajde, ai biznesmeni të ketë kapital, pallate, xhip e çka jo tjetër, mund të arsyetohet diqysh. Por, deputeti, ta zëmë, të cilit karrigen në Parlament ia ka siguruar vota e popullit, ai vëlla, kah i bëri pallatet, kah xhipin, kah restaurantet..."

Tjetri thotë: "Vallahi, marre po më vjen prej fëmijës, i cili një ditë më ngushtoi, s'dita t'i jap përgjigje, kur më pyeti: "Babi, pse ti s'je deputet?". Kishte arsye t'më pyeste, se shoku i tij i klasës dhe i bankës, asnjë ditë nuk shkon në shkollë pa 20 euro në xhep..."

Tjetri: "Sot për sot, për te ne e kam fjalën, bëhu politikan ndash për t'u bërë i pasur dhe i respektuar. Biznesi më i mirë sot është të merresh me politikë. Dhe, s'janë të paktë e as të rrallë ata që e kanë marrë vesh këtë punë, andaj edhe bëjnë yrrsh me të gjitha mundësitë e mjetet për të hy diqysh në politikë..."

Gani Dili

“Nuk do ma vrasin Ismail Qemalin pa më vrarë mua!”



Këtë janar mbushen 105 vjet nga vrasja e Heroit të Popullit, Isa Boletinit, nga forcat serbo-malazeze. Jeta dhe veprimtaria e tij me meritë të plotë zë një vend të dukshëm në historinë e popullit shqiptar të periudhës së Rilindjes Kombëtare dhe të Pavarësisë së Shqipërisë, duke u lënë brezave pasardhës mesazhe, të cilat u bënë për ta burim frymëzimi në luftën për çlirim dhe bashkim kombëtar.

Isa Boletini 35 vjet të jetës së tij ia kushtoi çështjes kombëtare. Në këtë hark kohor, angazhimi i tij ishte shumëplanësh në arritjen e qëllimeve madhore të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, për çlirim nga sundimi osman, krijimin e shtetit shqiptar, si dhe në luftën për çlirim dhe bashkim kombëtar. Drejtimi kryesor i kontributit të tij ishte ai i organizimit, masivizimit dhe udhëheqjes së luftës së armatosur të shqiptarëve, për të vënë në jetë programin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Përpjekja e tij disavjeçare, në bashkëpunim me udhëheqës të tjerë jo vetëm në Kosovë, por edhe në treva të tjera shqiptare, me deputetë shqiptarë në parlamentin osman, arritën t'i japin lëvizjes kryengritëse një shtrirje të gjerë dhe e pajisën me programin autonomist.

ÇKA I OFROI PORTA E LARTË ISA BOLETINIT QË TË TËRHIQET NGA QËLLIMET E TIJ?

Rritja e autoritetit të tij në këtë lëvizje tërhoqi vëmendjen e Portës së Lartë, e cila gjatë kryengritjeve 1909-1912, dërgoi disa herë pranë tij emisarët e

saj, ku i propozuan ofiqe dhe pasuri, me qëllim që ta largonin nga rezistenca antiosmane. Por, Isai nuk pranoi, i ktheu mbrapsht, duke iu përgjigjur: “Të kisha pranue me iu përulë Stambollit e me ma vue zgjedhën në qafë, të kisha mendue për kokë e pasuri, isha marrë vesh me kohë e nuk i kisha shti në grykë të topit e humbë kaq meshkuj e pasuri e djegë me qindra shtëpi të farefisit e të miqve. U falemnderës, tash nuk kërkoj të mirën teme, por të mirën e vendit tem. Unë jam mirë kur asht mirë Shqipëria”. Në të njëjtën kohë, ai nuk ngurroi që për nevojat e kryengritjes së vitit 1912 për armë e municion, të hynte disa herë në bisedime me të dërguarit e Beogradit. Por, asnjëherë nuk pranoi që në këmbim të armëve të lejonte ndërhyrjen serbe në punët e brendshme të kryengritjes dhe të programit të saj për krijimin e shtetit autonom shqiptar. Vendorsmëria e tij dhe e bashkëluftëtarëve të tjerë, bënë që kryengritësit në verën e vitit 1912 të çlirojnë pjesën dërmuese të qyteteve të Kosovës e të detyronin Portën e Lartë të ulej në bisedime e të diskutonte kërkesat e tyre. Në këtë moment, kur shqiptarët ishin më pranë fitores së autonomisë, veç kundërshtimeve të

qeverisë osmane për njohjen e kësaj kërkesë, u rritë edhe presioni i Fuqive të Mëdha, të cilat kërkonin ruajtjen e status quo-së së Perandorisë Osmane. Nga ana tjetër, për shtetet fqinje: Serbi, Mali i Zi e Greqi, krijimi i shtetit autonom shqiptar do të pengonte realizimin e planeve të tyre, për zgjerim territorial në drejtim të territoreve shqiptare. Kështu, së bashku me Bullgarinë, të bashkuar në Aleancën Ballkanike, në gusht nisën sulmet e para ndaj territoreve shqiptare në kufi me Malin e Zi.

Fillimi i luftës ballkanike, në tetor 1912, si dhe sulmi i ushtrive të shteteve fqinje drejt Kosovës e trevave të tjera shqiptare, vuri në lëvizje Ismail Qemalin dhe patriotët shqiptarë brenda e jashtë vendit, për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, e cila u realizua nga Kuvendi i Vlorës, më 28 nëntor 1912.

Kësaj nisme, ashtu si udhëheqës të tjerë të LKSH, iu përgjigj edhe Isa Boletini dhe të zgjedhurit e tjerë nga Kosova, të cilët mbërritën në Vlorë më 29 nëntor 1912. Në takimin me Ismail Qemalin, Isa Boletini, me urimin - të lumtë dora Ismail Bej, shprehu dëshirën e vullnetin e tij dhe të të gjithë popullit të Kosovës për aktin historik, duke miratuar plotësisht vendimin për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë.

SI E MBROJTI ISA BOLETINI VLORËN DHE ISMAIL QEMALIN NGA FORCAT PUSHTUESE?

Gjatë kohës së qëndrimit në Vlorë ai mori pjesë në disa mbledhje të Kuvendit të Vlorës, ku u zgjedhën organet e para qeverisë së shtetit shqiptar. Në krye të forcave të armatosura vullnetare, ai u vu në mbrojtjen e Vlorës nga forcat pushtuese, për mbrojtjen e jetës së Ismail Qemalit, si dhe sigurimin e veprimtarisë së Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Ai iu bashkua shqetësimit të Ismail Qemalit, Luigj Gurakuqit dhe punoi që pushteti i Qeverisë së Vlorës të shtrihej në ato qytete, të cilat ende nuk ishin pushtuar nga ushtritë fqinje ballkanike, si dhe mbrojtja në Janinë dhe në Shkodër të bëhej nën flamurin shqiptar. Ai i qëndroi pranë Ismail Qemalit dhe hodhi poshtë propozimet e Esat

Toptanit për t'u bërë pjesë e lëvizjes së tij përçarëse kundër Qeverisë së Vlorës dhe kryetarit të saj Ismail Qemalit. Në personalitetin e Ismail Qemalit ai shihte njeriun e kompletuar, që gëzonte cilësitë dhe aftësitë për të rregulluar qeverisjen e re të shtetit të ri shqiptar, i cili do të përbënte një faktor të rëndësishëm për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe viseve të tjera të pushtuara nga shtetet fqinje dhe bashkimin me shtetin amë. Andaj, ai, në këto kohë të trazuara e të paqarta, nuk e braktisi asnjëherë Ismail Qemalin dhe i qëndroi pranë deri në dorëheqjen e tij në janar të vitit 1914.

Bindja e tij u forcua akoma më shumë kur Ismail Qemali, në krye të delegacionit të qeverisë së Vlorës, pjesë e të cilit ishte edhe Isa Boletini, i bëri mbrojtjes së çështjes shqiptare në Londër në maj-qershor 1912.

Ashtu si Ismail Qemali, Luigj Gurakuqit etj., edhe Isa Boletini dha kontributin e tij si anëtar i këtij delegacioni. Në një sërë takimesh me zyrtarë të lartë dhe deputetë të parlamentit anglez, si dhe në intervista dhënë gazetarëve të vendeve të ndryshme, ngriti shqetësimin e tij për të ardhmen e Shqipërisë dhe tërësisë tokësore të saj.

Lidhur me vendimet që po merreshin në Konferencën e Londrës për kufijtë e Shqipërisë, Isai mbajti qëndrim të prerë, duke u shprehur botërisht kundër tyre. E quajti krejt të padrejtë vendimin e saj që linte jashtë Kosovën dhe trevat tjera shqiptare nën sundimin serb. Ai kërkoi që Konferenca të zgjidhte drejt çështjen nacionale shqiptare.

“Ne nuk kërkojmë asnjë katund më të vogël sllav. Por, çfarë është shqiptare të mbetët e jona”.

Dhe, nëse Evropa nuk do e zgjidhte drejt këtë çështje, ai paralajmëronte se Ballkani nuk do të kishte kurrë qetësi.

“Unë ju them sot se nuk do të mbesim skllav, por do të luftojmë derisa të çlirohemi nga duart e armikut, i cili është sjellë tepër barbarisht karshi nesh”. Pas mbërritjes në atdhe, në qershor 1913, ai iu bashkua zemërimit të popullit shqiptar, që ishte përhapur në të gjitha trevat shqiptare ndaj vendimeve të padrejta të Konferencës së Londrës, i cili u shpreh me protesta, mitingje dhe deri me organizimin e kryengritjes së armatosur (shtator

1913) për çlirimin e bashkimit të trevave të aneksuara nga Serbia.

Ushtria serbe e shtypi kryengritjen e shtatorit 1913, por nuk arriti të mbysë frymën e lëvizjes irredente që u ngjiz aty, e që në të ardhmen do të rritej, organizohej e forcohej dhe nuk do ta linte kurrë të qetë qeverinë serbe në sundimin e saj.

SI MUNDOHEJ BEOGRADI TA SHTIJË NË DORË ISA BOLETININ?

Pikërisht për këtë, qeveria serbe e drejtoi vëmendjen te figurat kryesore irredente, si Isa Boletini, Bajram Curri e Hasan Prishtina, u ofroi poste të larta dhe u premtoi se do t'u siguronte jetën po të ktheheshin në Kosovë. Por, ata hodhën poshtë ofertën e saj dhe vazhduan udhën e tyre në shërbim të Pavarësisë së Shqipërisë, të shtetit shqiptar dhe të luftës për çlirim e bashkim kombëtar.

Isa Boletini, Hasan Prishtina e Bajram Curri, duke shfrytëzuar kontradiktat e fuqive ndërluftuese gjatë Luftës së Parë Botërore dhe veçanërisht ato midis Serbisë dhe Vjenës, në shtator 1914 bashkëpunuan me komandën ushtarake austro-hungareze, për organizimin e një kryengritje të armatosur për çlirimin dhe bashkimin e Kosovës dhe treva të tjera me Shqipërinë, por nuk ia arritën qëllimit. Në pamundësi për të qëndruar e vazhduar veprimtarinë në Krasniqë, për shkak të gjendjes së vështirë të krijuar brenda vendit dhe forcimit të reaksionit të brendshëm, Isa Boletini, në qershor 1915, u largua në drejtim të Shkodrës. Hyrja më 27 qershor e forcave ushtarake malazeze në këtë qytet, u shoqërua me eliminimin e disa figurave të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, si Mustafa Qulli, Çerçiz Topulli etj. Për t'i shpëtuar arrestimit, Isa Boletini kërkoi strehim dhe ndihmë në konsullatën franceze, për t'u larguar drejt një shteti neutral. Por, dorëzimi i Isait nga konsulli Bilëkok te Mali i Zi, ndërpreu rrugën e tij për në vendlindje dhe paracaktoi më 23 janar 1916 fundin tragjik të jetës së këtij veprimtari të shquar të Lëvizjes Kombëtare, i cili sakrifikoi jetën e tij për pavarësi dhe bashkim kombëtar.

Fatmire Musaj



70-vjeçari mban në gjoks kryqin e gërvishtur nga paramilitari!

Në kafenenë “D3”, në lagjen “Ulpiana” në Prishtinë, të dielën e 24 janarit, një burrë i shtatëdhjetave, pinte kafe e raki bashkë. Flokëthinjur, serioz, shihej se ishte mysafir i rastit në Prishtinë, i rrethuar nga nja 4-5 vetë, të cilët me vëmendje e përcillnin çdo fjalë të tij...

Afër tyre pija kafe dhe me vëmendje përçolla përjetimet e tij gjatë luftës në Opterushë të Rahovecit.

U tregonte se si ishte rrethuar Opterusha në mars të vitit 1999 nga forcat serbe, po atë ditë kur edhe ishte bërë masakra e madhe në Krushë të Madhe dhe në Krushë të Vogël, pak ditë pasi filluan bombardi-

met e NATO-s më 24 mars.

Duke folur për rrethimin dhe ngjarjet që kishin pasuar atë ditë, ai zbërtheu kopsat e këmishës dhe në gjoks kishte të gërvishtur një kryq nga paramilitarët serbë.

SI IA GËRVISHTËN KRYQIN NË GJOKS OPTERUSHIANIT NË PRANI TË FËMIJËVE?

“E paske pasur zor me këtë kryq në gjoks. Si arrite ta ndalje gjakun?”, e pyeti njëri prej njerëzve që ndodhej në tavolinë me të. “U përmbajta, edhe pse gjaku më shkonte rrëke. Nuk dëshiroja të dorëzohesha para paramilitarit. Por, më së vështiri e kisha që kryqin në gjoks ma bënë në prani të fëmijëve të mi! U tmerruan. Bërtisnin... Kah ma gërvishte lëkurën, gjaku rrëshqiste rrëke!

Kurse, paramilitarët tjerë na kanë marrë gjithçka që kishim në xhepa...”

A PAT EDHE NGJARJE TË TJERA?

“Një numër të madhe të popullatës i kishin tubuar në xhaminë e fshatit. I

kishin ngjuar aty. Secilin e shikonin me rend: ta vrisnin a ta linin gjallë! E, të gjallët, pastaj, i orientonin drejt kufirit për në Shqipëri...”

Disa burra e djem të rinj i ndanë nga turma dhe dihej se çka i priste ata... Vëllai ma dha djalin e vet dhe më tha: “Vëlla, merrma djalin me vete! Po dihet se çka po na pret sot! Nëse ma vrasin, bile, të mos e shoh teksa e vrasin...”

Nisëm të qanim të dy. Djali i tij, edhe pse i ri, e kuptoi mesazhin e babait dhe u ofrua afër meje dhe nuk nxirrte fjalë nga goja... Dikur më tha: “Axxhë, mos më lë vetëm!”. Dhe, teksa na nxorën nga shtëpia, njëri i tha udhëheqësit: “Pse nuk kryet punë edhe me këta?!”

“Jo, këta le të nisen për në Shqipëri se boll vramë deri tash!”, ia ktheu ai.

Na orientuan nëpër hekurudhë dhe tërë natën mezi arritëm në kufi, në Vërmicë. Dhe, sa herë kam kaluar pastaj nëpër Vërmicë, më bëhet se i dëgjoj vajet dhe britmat e njerëzve teksa me kondak pushke godisnin këdo që mundnin...”, tha ai dhe nisi t’i përthekojë kopsat e këmishës, e që duart i dridheshin thujtë ishte po në ato ditë të tmerrit të vitit 1999.

Safet Krivaça



UNION BUSINESS
ALBANISCH & DEUTSCH

Zëri yt
të dëgjohet nëpërmjet
votës tënde.

VOTO!

14 Shkurti - fitore për
të gjithë!

Rajoni i Hasit të Prizrenit shtrihet në Malësinë e Gjakovës dhe të Prizrenit, i përbërë nga 38 fshatra e me mbi 40 mijë banorë dhe me një traditë të pasur kulturore e shpirtërore ndër shekuj. Element i veçantë, e që e karakterizon këtë trevë, pa dyshim, është edhe veshja unike tradicionale e njohur “Veshja e Hasit”, e cila konsiderohet ndër veshjet më karakteristike në Kosovë dhe më gjerë, të cilën e kanë ruajtur me fanatizëm dhe e kanë përcjellë e trashëguar brez pas brezi, deri në ditët e sotme, banorët e asaj ane.

“Hasi i Thatë”, jo më kot është quajtur kështu pjesa periferike e territorit të Rrafshit të Dukagjinit, duke pasur parasysh se në këtë zonë, vite e dekada më parë, e deri në periudhën e pasluftës, problem kryesor për popullsinë e saj ka qenë mungesa e ujit.

Kështu, në mungesë të kushteve bazë për një jetë më të mirë në vendin e tyre, meshkujt hasjanë ishin të obliguar që të merrnin rrugën e mërgimit, duke praktikuar profesionin e bukëpjekësit, e në vendlindje mbetnin vetëm fëmijët dhe pjesëtarët e gjinisë femërore.

Dhe, për t’iu përshtatur kërkesave



Pse gratë hasjane bartin kollan druri në kuka?

dhe rrethanave të imponuara të kohës, gratë hasjane e kishin adoptuar në mënyrë perfekte edhe veshjen e tyre tradicionale, e cila njihet sot si njera nga veshjet kombëtare më interesante në Kosovë dhe rajon.

UJË E DJEP MBI KOLLANIN NË KUKA...

Në këtë mënyrë, gratë hasjane, duke aplikuar vendosjen e një rrethi të punuar nga druri në bel, që në zharqonin lokal quhet “kulla” (kollani), e që është karakteristika kryesore e kësaj veshjeje, kishin zgjidhur edhe

problemin e bartjes së ujit dhe të djepit në të njëjtën kohë. Sepse, ky kollan, përveçse harmonizohej në mënyrë fantastike me stilin e veshjes, ai shërbente mrekullisht edhe si një mjet ndihmës për bartjen e burive me ujë, apo edhe të djepit me foshnje, duke i vendosur mbi të. Dhe, duke e bartur që nga dita e parë e nusërisë e deri në fund të jetës së tyre, kjo veshje ishte pjesë e pandashme e veshjes ditore e shumicës më të madhe të nuseve dhe të grave të Hasit në dekadat të tëra.

Pra, në ato vite, veshja hasjane punohej si një veshje e zakonshme, e cila

bartej në përditshmëri dhe ishte e domosdoshme. Nusët dhe gratë e martuara posedonin nga disa palë veshje, duke përfshirë edhe veshjet të cilat ato i quanin “të rënda”, të cilat visheshin nëpër dasma e gazmende familjare, pastaj veshjet “artesh” apo ndryshe të përditshmërisë, si dhe ato për rastet mortore dhe të zisë.

“Veshja e rëndë” (“veshja e ranë” sipas zhargonit lokal), ishte ajo veshje e punuar bukur dhe e përkryer deri në detaje, me një kolorit ngjyrash e lulesh të bukura, që ishte e përshtatshme të vishej gjatë dasmave nga nusët e reja.

Ndërkaq, veshja “artesh”, ishte e punuar më thjesht dhe vishej në përditshmëri, si nga nusët edhe nga gratë më të moshuara.

E, për rastet mortore apo të zisë, veshja hasjane punohej me sfond ngjyrash të errëta, por duke mos e humbur asnjëherë strukturën dhe zbukurimet e saj.

SA ZGJATË PUNA NË VEK E NJË VESHJEJE HASJANE?

Karakteristikë tjetër e veshjes së Hasit është edhe procedura e komplikuar e punës për realizmin saj, sepse i tërë



procesi bazohet krejtësisht në punë dore dhe vek, e që mund të zgjasë me muaj deri në finalizim.

Një veshje e kompletuar hasjane përbëhet nga tlinat, fundi, kollani, shoka (e cila lidhet rreth kollanit), mshtallaku, kanaci, rrëfanat (lidhëset), përparësat (mindilat), këmisha, xhamadani, dorëzat, mahrama dhe shamija.

A KEMI EDHE SOT VESHJE HASJANE?


Gjatë periudhës së luftës edhe fshatrat e Hasit janë djegur, duke u djegur edhe veshjet bashkë me shtëpitë në të cilat gjendeshin ato. Mirëpo, përkundër kësaj, edhe pse pas kësaj periudhe “Veshja e Hasit”

nuk vishet në përditshmërinë e grave hasjane, ajo ka mbetur një trashëgimi e rëndësishme e traditës etnografike, ku tani secila vajzë apo nuse, me patjetër do që ta ketë, së paku, një veshje të tillë solemne në kuadër të pajës së saj.

PËR FUND

Shtrohet pyetja: Kjo trashëgimi e pasur shekullore për të cilën folëm më lart, e bartur brezi pas brezi, e që pat një rëndësi të madhe si nga ana estetike, por edhe ajo e nevojës për gratë e trevës së Hasit, a do ia vlente që “Veshja e Hasit” të futej në listën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore e tradicionale të UNESCO-s?

Luan Dervishaj



Ai që më propozoi për deputet ma zuri vendin vetë!

Vetëm sa e bëra hapin e parë, njoha shumë politikanë, disa prej të cilëve përflireshin prej vitesh e dekadash, e disa të tjerë që shprehin ambicie për t'u përfolur.

Mos u befasoni nëse një ditë, kur ta keni bërë hapin e parë drejt fushës së minuar, të habiteni me njerëz të interesit. Mos u befasoni as kur ta keni bërë hapin e parë kah politika e ditëve tona, me mendjen se aty e keni vëllanë dhe ai do ua zgjat dorën për t'u qar në parajsë!

MË THANË: TI DO TË JESH DEPUTET!

Pesë muaj para zgjedhjeve të 14 shkurtit që po vjen, më ofruan pozitë të kandidatit për deputet të Kuvendit të Kosovës. Më pritën mirë në zyrat e partisë, me kafe në restorant.

Takimin e kishim lënë nëpërmjet mesazheve. Ai me të cilin kisha folur doli nga zyra dhe tjetri që erdhi, ngjashëm mu ofrua, bile erdhi në kafene vetë i dyti nga partia. Ma zgjatën dorën dhe më uruan suksese. Më premtuan se do ta kisha përkrahjen e kreut të partisë dhe më premtuan se nuk kisha kundër kandidat

që mund t'më sfidonte.

Kur u caktua data 14 shkurt për zgjedhje, më urdhëruan të bëj fushatë në oda e kafene, por edhe në salla dhe për këtë m'i ofruan edhe njerëzit e terrenit. Lista nuk ishte publikuar akoma, por dihej që unë do isha kandidat i sigurt.

Por, vetëm pak kohë para se të zyrtarizoheshin emrat për kandidatë për deputetë, filluan ndërkamcat e grupeve politike që punojnë nga nëntoka. Filluan linçimet dhe kundërshtimet. Grupet e interesit që janë në parlament që 20 vjet, filluan t'i tregojnë dhëmbët për pushtet...

Ashtu siç ishin mësuar të tradhtonin, porositën njeriun e tyre t'më propozonte mua edhe zyrtarisht për kandidat. E, unë, i pa djallëzuar, isha i bindur në sinqeritetin e fqinjit tim...

SI MË HOQËN NGJA LISTA NË MOMENTIN E FUNDIT?

Mirëpo, pas tri ditësh, propozuesi im, nuk më përshëndeste më! Nisa të habitësja me të se a mos nuk ishte ai që më kishte premtuar?! Dhe, pa u bërë as dhjetë minuta, iku pa më thënë as ditën e mirë...

Kur i lexuan emrat, e dëgjoj kah përmendet emri i tij në listë. Ai që më kishte propozuar mua si të vetmin, ai tash ishte në listë në vendin tim. Dhe, të gjithë ata që më kishin ofruar mbështetje pa rezervë, tani ishin në listë për kandidatë.

Më thanë se nuk kanë pasur qare pa hyrë

në listë, sepse ishin disa grupe politikanësh në Ferizaj, që kishin urdhëruar futjen e tyre në listë. Dhe, refleksionet e grupeve kishin ndodhur edhe në nivelin qendror. Ata që kishin vepruar 5 minuta në 12 kundër meje, tani qonin fjalë se më mirë që nuk isha në listë. Demek, kjo i binte që unë kam shpëtuar me fytyrë nga grupet kriminale të parapolitikës, sepse ata që janë propozuar e kanë pranuar këtë nën presion. Pse?

Sepse, ata gjatë tërë kohës me vite ishin furnizuar me mall e para prej atyre bosëve. Ata u kanë dhënë mall veresi, për t'i djegur si emra, pasi nuk qojnë peshë në politikë as si njohës të gjërave. Ata i fusin në lista për të dështuar, e pasi të dështojnë i marrin ato qindra vota që arrijnë t'i mbledhin dhe ua bartin emrave që janë pjesë e grupit të bosëve.

Dhe, krejt çka mora vesh nga kjo mesele, ishte një mësim i madh. Vija kriminale politike fillon nga baza krejt e parëndësishme, zhvillohet në nivel dege dhe përfundon në qendër. Është i njëjti tren kriminal ku individët bëhen të pasur dhe pasi të bëhen të tillë, fusin në dorë kapitalin e mallin e shkëmbejnë me njerëz.

Pra, të mirët nuk i lënë të avancojnë. Të këqijtë i qojnë në kandidatura, me ndonjë përjashtim. Dhe, ata që arrijnë të ecin tutje sërish, janë njerëz të bosëve që kanë për ta mbrojtur shtetin në parlament dhe që kanë për të përligjur ligjshmëritë dhe proceset e shtetndërrimit.

Safet Krivaça

BOOM

Angelina Shala

imazh i dizajneres

së famshme

Flora Suldashi

Yjet e serialeve turke
që nuk jetojnë në luks

Për këngëtarët
ka ndalesa,
për politikanët jo!

Ç'fat patën miset
më të bukura shqiptare?

Në ballinë të "Boom"-it: Angelina Shala

Angelina Shala, imazh i dizajneres së famshme Flora Suldashi



Është krejt e natyrshme që arti t'i bashkojë artistët. Kështu ka ndodhur edhe me dizajneren e njohur shqiptare në Gjermani, Flora Suldashi dhe këngëtarën e aktoren e afirmuar, Angelina Shalën.

Ato i kanë bashkuar forcat për të prezantuar para publikut një sesion fotografik mbresëlënës, ku dominon sharmi, eleganca, kreativiteti dhe, mbi të gjitha, forca e femrës.

Bukuroshja Angelina Shala, së fundi, është shndërruar në modele dhe ka realizuar një seri fotosh perfekte në studion e Norik Ukës, veshur me fustanet unikë të dizenjatores Flora Suldashi, që njihet si artiste prestigjioze.



PSE FLORA SULDASHI E ZGJODHI ANGELINËN?

Dizajnerja shqiptare tregon se pas studimeve universitare në Prishtinë, nisi të merrej më shumë me veprimtarinë e modës, meqë pak a shumë ishte diktat i kohës. Tutje kishte fatin e mirë të studionte në Akademinë e Modës në Gjermani, pasi kishte për qëllim që në këtë lëmi të hynte në mënyrë profesionale dhe.

Pas studimeve ajo hapi biznesin e saj të njohur “Flora S”, që tanimë është i licencuar dhe i mbrojtur në Gjermani.

Dizajnerja e modës me famë evropiane, pothuajse për një dekadë, ka realizuar koleksionet e fustaneve për “Miss Germany” dhe këto koleksione janë shfaqur para publikut elitari.

Flora Suldashi e ka punuar edhe fustanin ikonik të martesës së princeshës shqiptare Elia Zaharia-Zogu, duke bërë që krijimi i saj të mbetet vlerë e monarkisë shqiptare dhe do të ruhet në Muzeun e Mbretërisë Shqiptare.

Ndërkohë, së fundi, dizajnerja ka bashkëpunuar me një nga emrat më të famshëm të shou-bizit shqiptar, këngëtaresh, aktoren dhe gruan e biznesit, Angelina Shalën, e cila rrezaton sharm dhe elegancë.

“Duke dashur të thyej këtë pesimizëm të pandemisë, të ngre optimizëm dhe të sjell pak freski, realizuam një bashkëpunim të tillë.

Angelina i ka hyrë botës së artit dhe po shpалosë dhuntitë e saj, pse jo edhe si modele, sepse ka fytyrë markante dhe stil paksa misterioz, që patjetër është interesant për botën e modës.

Nga aspekti motivues, është një vizion i dy artisteve që jetojnë në Diasporë dhe që ndërldhin mundësinë për bashkëpunim”, ka thënë dizajnerja e modës, Flora Suldashi.

ANGELINA SHALA: “U NDJEVA DIVË”

Në anën tjetër, Angelina ka treguar se ishte kënaqësi e veçantë të barte

kreacionet e artistes shqiptare.

“Flora më kontaktoi, pasi e kishte idenë për bashkëpunim. Pranova menjëherë, meqë kisha lexuar në mediet gjermane për punën dhe aftësitë e saj si dizajnere e modës. Isha kurioze ta shihja se a do ta gjente stilin tim. Ajo e gjeti lehtë, sikur i lexonte ëndrrat e mija. Dhe, më bëri të ndihem si një divë”. Bukuroshja shqiptare me karrierë të bujshme, ishte fascionuar me stilin ekstravagant të secilit kreacion.

Angelina tregon se fotot janë realizuar nga Norik Uka, meqë është fotograf profesionist dhe me një punë të admirueshme.

“E kam përcjell punën e tij dhe, sa kam mundur të shoh, ai e nxjerr më të mirën te një person. Është tejet profesional dhe i organizuar mjaft mirë me stafin e tij”.

Thotë se ia ka arritur ta tregoj veten në çdo foto, pasi është ndjerë rehat gjatë gjithë “photo session”-it”.

KËNGËTARE, AKTORE, BIZNESMENE E DALLUAR

E, meqë publiku e njeh si këngëtare, ishte e udhës që Angelinën ta pyesnim edhe për muzikën, por edhe për aktrimin dhe biznesin.

“Muzika për mua është terapi emocionale, kurse aktrimi është diçka që unë e ndiej se kam lindur për të, e për biznesin mund të them se jetoj me të.

Ndërkaq, moda është diçka emocionale, që e shfaqë ndjenjën përbrenda që e ke dhe e dëshmon në bazë të modës dhe fotove se ti je kjo që ndjehesh. Është ëndërr e çdo femre”.

Angelina Shala porosinë femrat që t’i besojnë vetvetes dhe ta vlerësojnë veten më shumë se çdo gjë. “Gjithmonë duhet t’i marrësh kritikën si kompliment, të jeni vetvetja dhe të luftoni për qëllimet tuaja, ani pse mund të ketë shumë pengesa rrugës. Por, triumfi në fund do të vijë dhe do të jetë shumë i ëmbël”.

Nderim Neziri



Yjet e serialeve turke që nuk jetojnë në luks

Serialet turke janë bërë shumë të njohura, ndërsa bie në sy jeta luksoze e aktoreve. Por, në fakt, çfarë jepet në film ngelet aty, sepse jeta e tyre është shumë ndryshe në realitet...

AKTORJA LUKSOZE JETON NË FSHAT

Aktorja Aslihan Gurbuz, në realitet, nuk jeton në një lagje të pasur. Përkundrazi, jeton në fshat. Atë e shih shpesh të pozojë në lëndina, me kafshë, duke mbledhur fruta nga pemët e veprime të tjera.



BUKUROSHJA E SERIALEVE QË JETON THJESHT

Edhe aktorja Bade Isçil bën jetë shumë të thjeshtë, nuk vishet me firma si në serial.

Ndërkohë, në serial shfaqet si nënë e përkushtuar ndaj fëmijëve e familjes, por në jetën reale aktorja është e kundërta. Ajo është e përqendruar te karriera dhe nuk ka ndërmend për momentin të krijojë familje.



GOKÇE BAHADIR ME PANTALLONA TË GRISUR NË PËRDITSHMËRI

Aktorja Gökçe Bahadır në serial shfaqet si femër serioze, e veshur gjithnjë me kostume. Por, në realitet atë e sheh me pantallona të grisur, bluzë të shkurtër e flokë të shkapërdhur.

Ajo është, gjithashtu, këngëtare dhe në skenë shfaqet shpesh me veshje ekstravagante.

D. H.

Për këngëtarët ka ndalesa, për politikanët jo!

Partitë politike, pavarësisht situatës me COVID-19, nuk po i ndalin tubimet zgjedhore. Ndërkohë, dasmat e ahengjet janë ndaluar prej kohësh. Kjo ka bërë që këngëtarët të ngritin zërin, pakënaqësinë.



XENI REAGON: PSE PARTIVE U LEJOHEN TUBIMET?

Së fundi, në rrjete sociale kanë qarkulluar imazhe të shumta nga tubimet me shumë njerëz, ku ekziston rrezik i madh i infektimit me koronavirus.

Këngëtari Shkëlzen Jetishi-Xeni, me anë të një postimi në Instagram, reagoi lidhur me tubimet e partive.

“Hajde rregull hajde...”, ka shkruar ai, duke ua kujtuar që dasmat ende nuk lejohen të mbahen, pikërisht për shkak të evitimit të turmave.

ROVENA: A QENKA LARGUAR PANDEMIA, A?!

Në lidhje me këtë çështje, edhe këngëtarja e njohur, Rovena Stefa, ka bërë një reagim publik në rrjetet sociale. Ajo ka ndarë me ndjekësit e saj në InstaStory një shqetësim që ka të bëjë me fushatën elektorale që po zhvillohet në Kosovë, në kuadër të zgjedhjeve të jashtëzakonshme që do të mbahen më 14 shkurt.

Këngëtarja ka publikuar fotografi të një prej tubimeve politike në Kosovë, ku shihen në një sallë shumë njerëz, e që i tejkalojnë kapacitetet e grumbullimit të përcaktuara nga IKSHPK.

Në mbishkrimin e kësaj fotografie, Rovena shkruan pse është ndaluar organizimi i dasmave e jo edhe i tubimeve politike në kohë fushate...

“Paska mbaruar pandemia kur do politika fushatë! Po dasmat pse nuk i lejojnë?!” , ka shkruar Rovena Stefa në InstaStory.

Me këtë, këngëtarja nga Shqipëria, sikur deshi të tregojë se në Kosovë praktikohen standarde të dyfishta, ndryshe për njerëzit me pushtet e ndryshe për njerëzit e thjeshtë.

Reagime të ngjashme për lejimin e grumbullimit të njerëzve në masë, në këtë kohë pandemie, ka pasur edhe nga përfaqësues të gastronomisë.



AFRIM MUQIQI: DO NISI DASMAT...

Kohë më parë, në diçka të ngjashme, ka reaguar edhe Afrim Muqiqi, që është zë i fuqishëm në estradë.

Këngëtari i njohur kosovar ka komentuar festën e fitores së VV-së në Llap, pasi aty ishin mbledhur mijëra persona.

“Pasi u mblodhën sot, nga nesër fillojmë me dasma! Po, është një porosi ironike, pasi gjithë këta politikanë që na kanë thënë të mos dalim e të mbajmë distancë sociale, nëse kanë fije morali, atëherë ku është logjika që të dalin në shesh, e të ndalohen ahengjet familjare! E dini fare mirë si e kanë dëmtuar ekonominë, e deri te parukeritë”, kishte thënë Muqiqi.

N.



Ç'fat patën miset *më të bukura shqiptare?*



AGNESA VUTHAJ

“Miss Kosova 2003”, “Miss Albania 2004”, Agnesa Vuthaj, vajzë me bukuri tipike mesdhetare, rrëmbeu çmimin e më të bukurës në trojet shqiptare. Agnesa i ruan ende linjat perfekte të një vajze mjaft tërheqëse.

Prej disa vitesh ajo ka dyqanin e saj të veshjeve, “Agnesa Vuthaj Fashion”, në Prishtinë dhe është shumë aktive në shou-biz. Ajo ka krijuar edhe një linjë të sajën për këpucë e çanta.

SUADA SHERIFI

Suada Sherifi ishte “Miss Albania 2005”. Ish-basketbollistja e skuadrës së Tiranës, vajza shtatlartë vlonjate, me zërin e ëmbël, e vijoi karrierën e saj me reklama e dalje televizive mjaft të shpeshta.

Ka sfiluar thuajse çdo vit në pasarelën e “Geraldina Sposa”. Sidoqoftë, Suada Sherifi mbetet ende një nga miset më të bukura shqiptare që i kanë rezistuar kohës.

Tash është nënë e një vajze.



ARMINA MEVLANI

Armina Mevlani, “Miss Albania 2009”, përfaqësuese e Shqipërisë në “Miss World”, ku ka fituar çmimin për fustanin më të bukur në botë. Për momentin është personazhi më i komentuar i medieve rozë, jo vetëm për suksesin e saj si blogere, por edhe për lidhjen e dashurisë me djalën e ish-kryeministrit Berisha, Shkëlzenin.

N.

Halla Nazë tregon si u martua para 74 vjetësh?

Halla Nazë, ashtu siç e thërrasin të gjithë në lagjen tonë, sapo i ka mbushur të 90-at. Nga shumë ndodhi gjatë jetës që ka përjetuar, ajo tregon paksa në hollësi për kohën kur u martua në moshën 16 vjeçe...

"Më fejuan kur isha 16 vjeçe, pa më pyetur fare. Më fejuan për burrin tim të ndjerë, për atë që më bëri namin, më bëri hallin, për atë që i bëri muhabet miletit për të keqen që më solli mbi kokë!
U krye kjo punë, i mirë ose i keq, unë e kisha detyrim të përshtatesha; nuk guxoja të kundërshtoja nga babai, edhe pse nëna ishte në anën time dhe si nënë më kuptonte

me shpirt...

Ishte si ishte, një ditë një vajzë e mëhallës më solli një fjalë nga i fejuari im. Ai dëshironte të takohej tinëz me mua. Dëshironte të ndërrom ndonjë fjalë dashnie ndërmjet veti dhe po nuk i dola në takim do vinte te shtëpia dhe do gjuante me guri në xhamin e dhomës sime. Unë frikësohesha nga baba dhe nuk dola. Por, çka ishte më e keqja, ai pastaj bëri problem, tërë natën e lume më trokiti te dritarja ime, e që ato krisma i kishin dëgjuar edhe të tjerët në shtëpi, por nuk e dinin se çka po ndodhte...

SI E LIDHI BABA QENIN TE DRITARJA E DHOMËS SIME?

Dhe, nga nata tjetër, baba e lidhi qenin afër dritares së dhomës sime dhe më ai nuk guxoi të vinte... Ditën tjetër prapë erdhi po ajo vajza dhe më tha se i fejuari im dëshiron gjithqysh të më takoj. I

thashë: "Mirë, le të vijë në mbrëmje te dritarja ime, e unë qenin do e largoj para se ai të vinte".
Pas darke qenin e futa në ahur. Nëna dhe baba veç kishin fjetur në atë kohë. I fejuari im erdhi te xhami i dhomës sime dhe trokiti lehtë. Unë e hapa dritaren dhe këceva në tokë...

NUK LEJOVA T'MË PREKTE ME DORË DERI NË NATËN E PARË TË MARTESËS!

Folëm sa folëm, por nuk e lejova t'më prekte me dorë. Dhe, pas pak dëgjoj një zhurmë nga ahuri, qeni bënte përpjekje të dilte nga aty dhe doli. E, për të shpëtuar nga qeni, i fejuari im shpejt e kërceu gardhin dhe ia mbathi...
Por, më nuk u takuam asnjëherë deri kur edhe u martuam, kur për herë të parë ai edhe më preku me dorë në natën e parë të martesës...

D. T.



Gur mbi Gur...



Blej Banesën tënde me super ofertë

pa kamatë, pa garantues, 60 muaj
direkt në Cima Construction

049 656 666 | www.cimaks.com | cima.shpk@gmail.com

fc Ballkani



Since 1947



fb.com/Ballkani1947



www.fcballkani.com

RESTAURANT

LORIANO

LOUNGE & BAR



Lorianò, një tregim i ri



040 561 526 | kemal.radic@gmail.com | Lorianò Restaurant

Dreqi më qoi që e mora burrë profesorin e jo naj politikan!

Shumë nga gratë e rëndomta ua kanë zili grave që i kanë burrat të famshëm, politikanë. Do të jepnin gjithçka që edhe burri i tyre të ishte i njohur. Por, ka edhe të tilla që mendojnë ndryshe...

V. T., 41 VJEÇE, NGA PRISHTINA:

- Jam e martuar dhe i kam dy fëmijë. Im burrë është profesor. Kurrë nuk do e merrja burrë politikanin. Sepse, po e shihni edhe vetë se si po zhyten në korrupsion, në dallavere me tenderë të ndryshëm, në afëra korruptive e të tjera të ngjashme. Thjesht, më pengon fama e burrit, sepse ai pastaj do e ndjej veten se është dikush e unë do mbetëm nën hijen e tij...

Shkurt e shqip: Nuk dua që burri im të jetë në qendër të vëmendjes, por unë. Sepse, po të jetë ai në qendër të vëmendjes, pa dyshim, nuk do të ketë kohë t'më përkushtohet mua, por ndonjë tjetër, me të cilën edhe e lidhë vendi i punës, udhëtimi zyrtar, shoqëria.

Andaj, shyqyr Zotit, burrin e kam profesor: shkon në mësim, kthehet pas mësimit te unë dhe bashkë me fëmijë pasdite dalim në ndonjë vend për të pirë kafe apo edhe në shëtitje.

S. B., 39 VJEÇE, NGA PEJA:

- Do të doja ta kisha burrin të famshëm, bie fjala, të jetë futbollist apo i ndonjë sporti tjetër, por kurrësi edhe politikan, këngëtar apo artist. Bie fjala, po të jetë im

burrë artist, ai do luajë edhe role të ndryshme dashurie. Pra, do të jetë në përqafim të tjetrës. E, unë të shkoj në teatër e ta shikoj se si puthet ai me tjetrën, a?! Jo, sepse jam xhelozë dhe nuk do toleroja gjëra të tilla kurrë.

Im burrë është inxhinier, ka firmë të veten dhe punon pa ndalur, kështu që edhe punët i kemi mirë. Unë i jam përkushtuar me mish e shpirt vajzës sonë, ajo tash është 5 vjeçe: e dërgoj në çerdhe dhe vetë kthehem në shtëpi e i kryej punët e shtëpisë. Kah ora 14 shkoj në ndonjërin nga kafiteritë që ndodhen afër çerdes së vajzës, takoj ndonjë shoqe, por ka raste edhe ndonjë shok nga shkolla e mesme dhe pi kafe nga një orë e një orë e gjysmë, deri kur edhe vjen koha që ta marr vajzën nga çerdhja.

L. E., 43 VJEÇE, NGA FERIZAJ:

- Thënë të drejtën, ndoshta pse jam e lindur e rritur në fshat, e që nuk ishim mirë materialisht, nganjëherë më shkon mendja te gratë që i kanë burrat politikanë dhe them lum ato: kushte të mira po, shëtitje po, verës në det po, vetura luksoze po, ahengje e sorollatje poshtë e lart po. E, çka i duhet njeriut tjetër? Por, ka edhe raste që kur po i dëgjoj në televizor se si po i shajnë disa nga politi-

kanët tanë që po vjedhin sa po mundin, e atëherë them me vete: shyqyr Zotit që im burrë është punëtor administrate dhe nuk ka çka me vjedhë se, ndoshta do të bëhej si ata që i përmenda më lart.

Sidoqoftë, kur kthehet burri nga puna, unë dhe fëmijët (një vajzë e një djalë e kemi), ulemi bashkë dhe hamë drekë, pastaj ai shikon televizor, kurse unë i laj enët apo ndonjë gjë tjetër. Në mbrëmje, thënë të drejtën, kënaqem duke i shikuar serialet turke dhe jam mishëruar me to. E, për dalje në dreka e darka, siç bëjnë gratë e politikanëve tanë, unë nuk i kam kushtet, por nuk prish punë, edhe pse nuk dal. Shpesh me fëmijë shkoj në familjen time dhe rri nga dy-tri ditë, e fëmijët kënaqen në ajër të pastër, sepse majën e Lybetenit e kemi shumë afër.

ÇKA MUND TË PËRFUNDOJMË?

Jetë të mirë bëjnë gratë e politikanëve, por edhe problemet i kanë të mëdha: ku shkoj burri, pse nuk erdhi ende, sa do të rrijë këtë herë në udhëtim zyrtar, a do e qesin edhe tim burrë në televizor për hajni, siç po i publikojnë të tjerët, e të tjera të ngjashme, brenga të cilat gratë e martuara me burra të thjeshtë nuk i kanë. Edhe kjo mjafton, a?

Diturie Haxhaj



*Qendra
më e madhe
e dobësimi
në Kosovë*



* Të lodhur nga mbipesha? Ndryshimin e shpejtë e gjeni te ne!

* Mbipesha është një gjendje nga e cila shkaktohen një numër i madh i sëmundjeve, si: sëmundje të zemrës dhe infarkti, rritje të presionit arterial, diabeti, dhimbje shpine, gurët në tëmth, osteoartriti, probleme me frymëmarrje, konkretisht astma dhe apneni, disa kancerw, depresion etj.

* Qendra e Dobësimi "Shkenda Dubova" që disa vjet ndihmon në trajtimin dhe humbjen e peshës, duke ofruar programe të përshtatura për individët, të cilët janë duke luftuar mbipeshën dhe kilet e tepërta. Përmes aparaturave tona ju do të eliminoni dhjamin në mënyrë natyrale, si lloj gjimnastike pasive, duke kaluar nëpër 5 lloje të aparaturave. Humbja në peshë nëpërmjet aparaturave vjen si pasojë e djegieve të kalorive.

* Te ne humbja e kilogramëve nuk është e vështirë dhe shumë shpejt do e ndërroni pamjen tuaj nga mbipesha në peshë ideale. Qendra jonë përdorë aparaturat më moderne të gjeneratës së fundit të specializuara në këtë fushë. Gjatë një seance realizohen pesë procese: dobësim, modelim, drenim, tonifikim dhe detoksikim. Një seancë e plotë dobësimi ka kohëzgjatje 2,5 orë.

* Së pari klienti i nënshtrohet një analize trupore, ku përcaktohet: masa dhjamore, masa hidrike, masa muskulore dhe skeletore, si dhe metabolizmi. Si rezultat i kësaj terapie klienti humbë 5-8 kg në 10 seanca të plota dobësimi dhe reduktim të perimetrit deri në 10 cm për vetëm 10 seanca. Le të shikojmë në detaje karakteristikat e aparaturave:

* Perfect body-tunnel sauna. Kjo është një aparaturë e fundit dhe rezultat i një projekti të gjatë kërkimor, efikasiteti i të cilës është verifikuar shkencërisht në të gjitha aspektet mjekësore, teknike dhe pa efekte anësore, kuruese për shumë sëmundje. Aktivizon molekulat e ujit, duke përmirësuar thithjen e oksigjenit, përmirëson qarkullimin e gjakut, nxit metabolizmin. Rrezet infra të kuqe të afërta dhe të largëta kombinohen për të depërtuar në indet e lëkurës deri në 30% (6 mm nën epiderme) dhe shpërbën grumbullimin e yndyrës të lokalizuara në bark, vithe dhe kofshë. Në mjekësi IR përdoren për shërimin e shumë sëmundjeve, si: sëmundjet reumatike; sëmundjet degjenerative të nyjave; gjendjet postraumatike (kryesisht sportistët); inflamacionet e hapësirave paranazale etj.



* Body shape – kabina e shtrirë. Një tjetër pajisje që sjell shumë benefite të jashtëzakonshme për shëndetin, e në veçanti në humbje të peshës. Realizon një funksion të rëndësishëm në relaksim e muskujve dhe detoksifikimin, duke larguar toksinat dhe acidin laktik. Benefitet: - Riaktivizon metabolizmin dhe ndihmon në eliminimin e shtresave të tepërta dhjamore. - Eliminon kilogramët e tepërt dhe rimodelon formën trupore. - Lehtësimin e dhimbjeve nga patologji të ndryshme, si dhimbja e kurrizit, nervit ishiatik, artritin, reumatizmin. - Rrit qarkullimin e gjakut, duke furnizuar kështu indet dhe çdo pjesë të trupit tonë me elemente ushqyese. - Tonifikim i thellë. - Përmirëson shëndetin e zemrës dhe ul stresin. - Përmirëson sistemin nervor. - Zhduk në mënyrë të ndjeshme celulitin, duke eliminuar shtresat dhjamore. - Ngadalëson efektin e plakjes, duke përmirësuar dukshëm elasticitetin dhe butësinë e lëkurës. - Përmirësim i dukshëm i drenimit të toksinave dhe i lëngjeve. - Detoksifikim i organizmit, rritje e forcës dhe fleksibilitetit. - Lehtëson gjendjen e depresionit.

* Sauna tradicionale nga druri i pishës. Është aparaturë ku përmes efektit termik të nxehtësisë ndihmon në eliminim e shtresave dhjamore dhe humbjen e peshës. Disa nga benefitet e saunës me nxehtësi: - detoksifikim; përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ul tensionin arterial; humbje të peshës; eliminon celulitin edhe nga zonat më delikate; relaksim muskolor.

* Elektrostimulatorët muskolorë. Ky është procesi i fundit që bëhet gjatë një seance. Është një proces shumë i rëndësishëm përderisa jeni duke shkrirë dhjamin, përmes elektrostimulimit tonifikohet trupi, nuk e lë të varet dhe të qullet trupi, stimulohet muskujt dhe ngushtohet perimetri. Vërejtje: Personat me probleme kardiovaskulare (të zemrës, venave), diabetit, shtatzënat dhe ata me epilepsi nuk u lejohet përdorimi i aparaturave tona.

PRISHTINË: 045/224-540
(Dragodan tek komuna e re)

GJILAN: 045/505-043
(Mbrapa postës së madhe)

GJAKOVË: 044/545-444
(Në tranzit rr.Tirana)

Ato tashmë janë shumë të njohura. Kanë karrierë të bujshme muzikore. Pos fillimeve të hershme me këngën, disa nga këngëtarët tona kanë filluar herët edhe jetën bashkëshortore. Madje, në moshë shumë të re janë bërë edhe nëna. Cilat janë disa prej tyre?



GJYSTE VULAJ

Këngëtarja Gjyste Vulaj është njohur me bashkëshortin e saj, Sokolin, që në moshën 15 vjeçe, ndërsa në moshën 16 vjeçe u martua.

Këngëtarja nga Malësia e Madhe, si 20-vjeçare, solli në jetë fëmijën e parë të saj, Rozanën, kurse pas afro 20 vjet martesë, vjen në jetë edhe djali i saj, Besarti.

Dhe, pavarësisht "gojëligëve" që flasin mbi jetën e saj personale dhe bashkëshortore, duket se të gjitha këto vetëm sa ia shtojnë dashurinë e madhe që ka për burrin e saj, Sokolin...

Cilat këngëtare tona u martuan 16 vjeçe?

ALBËRIE HADËRGJONAJ

Ndonëse është nënë e dy vajzave, këngëtarja Albërie Hadërgjonaj nuk është bërë nuse asnjëherë. Këngëtarja deçanase është bërë nënë në moshën 16 vjeçe. Si gjimnaziste në Deçan ajo u njoh me Mentorin. Ishte vetëm 15 vjeçe, ndërkohë situata e vështirë që kishte filluar në vitet 80 në Kosovë bëri që ajo, bashkë me Mentorin dhe familjen e tij, të shpërngulen për në Amerikë.

Pas vetëm një viti, pra në moshën 16 vjeçe, Albëria bëhet nënë, duke sjell në jetë vajzën e madhe, Agnesën. Pas dy viteve në Amerikë lind edhe vajza tjetër, Anxhelina, e cila tashmë është e njohur edhe si këngëtare.

"Të them të drejtën nuk u martova asnjëherë. Regjimi i Milosheviqit s'na la ta gëzonim jetën siç duhej ta gëzonte një adoleshente. Mbetëm me trasta në krahë, sa në Kosovë e sa në Amerikë dhe nuk patëm mundësi të bënim dasmë", ka thënë këngëtarja Hadërgjonaj, e cila që nga kthimi nga Amerika jeton në Tiranë.



ELI FARA

Ka mbetur "single" që në kohën kur u nda nga bashkëshorti i saj, Luli Kapurani, të parin mashkull që kishte njohur e që u bë babai i vajzës së saj të vetme, Marinës.

Eli Fara vazhdon të mbetet një ndër ikonat e bukurisë, sharmante dhe e ëmbël, edhe pse i ka kaluar të 50-at. Këngëtarja korçare u njoh me ish-bashkëshortin e saj që në moshë të re. Filloi të bashkëjetojë me të ende pa i mbushur 17 vjet. Ndërkohë, u bë edhe nënë.

Në moshën 20 vjeçe Eli u nda nga bashkëshorti i saj, duke e rritur vajzën pa praninë e babait. Çifti në atë kohë u ndanë, ngase kishte ndodhur një sherr midis grupeve, ku pati edhe një vrasje. Pas divorcit dhe burgosjes së ish-burrit, Elit iu desh të shpërngulet për të jetuar për shumë vite në Amerikë. Më pas ajo kthehet sërish në Shqipëri për të vazhduar aktivitetet e saj muzikore. Këngëtarja Fara këshillon se martesë në moshë të re është një gabim shumë i madh.

"Nuk e konsideroj gjë të mirë faktin që jam martuar në moshë shumë të re, që kam lindur fëmijën kaq herët. Do të ishte mirë që të lindja një fëmijë kur të isha më e formuar si grua dhe më e pjekur si femër, t'i jepja dashurinë që duhej vajzës sime dhe të kënaqesha shumë më tepër me të", ka këshilluar ajo.



A.

Sharmi i Ana Rustemit e djegë televizorin!

Ana Rustemi, moderatorja bukuroshe e ekranit, dikur ishte prezantuese në KTV, kurse tash është në "Klan Kosova", por gjithnjë me qeshje e me sharm.

E bukur dhe modeste, me stil unik në fushën e moderimit në ekran, Ana Rustemi, ish-prezantuesja e KTV-së, kurse tash në "Klan Kosova", është mjaft pozitive në çdo paraqitje të saj. Fillimisht karrierën e saj televizive e ka pasuruar me emisionin e mëngjesit, pastaj me emisionin "Jeta", ku përmes tij janë bërë të famshëm shumë personazhe, të cilët e kanë prezantuar veprimtarinë e tyre.

Dhe, në bazë të këtij emisioni, ajo kishte fituar edhe çmimin e Diasporës. Më vonë vazhdoi me emisionin "Shija e Anës".

Sidoqoftë, krahas paraqitjes së saj në ekran si moderatore, karakteristike e saj është edhe bukuria dhe sharmi i saj, i cili është tejet i veçantë.



U dha lajmi se ka vdekur hoxha...

Mos vdis aga hoxhë, se ty të donë edhe gratë e mëhallës!

Ngado që nisem arrij te lotët! E nisi këtë ditë si shumë të tjera, kur edhe zgjohem në mëngjes mbushur me elan, por nuk zgjat shumë dhe dita m'i kthen lotët. Kushëriri im më thotë se paska vdekur hoxha i mëhallës sonë.

E, si të mos qaj për të kur burrë si ai nuk ka pasur?

Më askujt s'i bën përshtypje hal-lalli! Njerëzit janë bërë të krisur, janë mbushur interes dhe kjo më djeg në shpirt. Vetëm dikush është që ma shuan mallin. Por, mua nuk më takon të shpresojë për të, sepse ajo është larg meje. Kur më merr malli për të, e pres mesnatën. Para vetes i vendosi dy gota verë. Njëren e zbrazti sa e sa herë, e tjetrën e lë në vendin e saj. Në këtë moment nisin lotët dhe kështu çdo gjë sërish kthehet në vendin e vet, aty ku më pushtojnë lotët për mallin e pashuar...

TË NESËRMEN VDES HOXHA...

E diel. Derisa gruaja i bënë kafet, më cingëron telefoni. Është një kushëri imi.

"Çka e paska gjet kaq herët?!", e solla në mendje.

"Hoxha i mëhallës sonë ka vdekur" më thotë ai. "Shumë keq na ka lënë, bre!".

Gruaja i sjellë kafetë, kurse unë ofshana thellë. Vdekja e hoxhës më tronditi, aq sa kafja më mbeti në fyt...

U ngrita që të shkoja te kushëriri, që bashkë të shkojmë për ngushëllime. Kur arritëm te xhamia, hoxha ishte aty! Unë e kushëriri mbetëm të habitur... Si ishte e mundur hoxha të ishte gjallë?! "Aga hoxhë, dëgjuam se ka vdekur dikush", i tha kushëriri im.

"Po, ka vdekur haxhi Qerkini", na thotë ai.

Në ato çaste morëm frymë thellë dhe sikur nxorëm nga mushkëritë frymën e zënë... Kushëriri i tha:

"Zoti mos na lashtë pa ty, aga hoxhë, se nuk ta dimë kimetin sa i madh je!".

"Pse thua ashtu?!", pyeti hoxha.

"Në mëhallë u përhap lajmi se ka vdekur hoxha... I madh e i vogël qamë me lot... Qanë edhe graria për ty... Mos vdek aga hoxha se krejt po qajshin për ty!", i thashë, teksa mundohesha t'i jepja fund kësaj bisede.

S.



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE



A dinë shqiptarët të puthin?

Dashuria pa puthjen nuk do të kishte kuptim. Kjo është një e vërtetë të cilën e ka pranuar tërë bota, madje edhe njerëzit më të prapambetur. Ajo është një forcë që vjen nga brenda dhe shpërthen në buzë. Por, jo çdokush i kush-ton rëndësi puthjes. Andaj, ç'kujtime kanë të rinjtë tanë për puthjen?

LINDA DHE VALONI: PUTHJA NA E SHPËTOI LIDHJEN!

- Ishim në prag të shkatërrimit të lidhjes sonë. Edhe pse kishim 5 vjet që ishim bashkë, jeta jonë sa vinte e bëhej ferr nga xhelozia e tepërt që kishim për njëri-tjetrin. Mospajtimëet sa vinin e shtoheshin. Filluam të mos e duronim më njëri-tjetrin. Një natë veç sa nuk u ndamë. U shtrim në shtrat të flinim, por gjumi nuk na merrte. Në një moment fytyrat tona u ndeshën. U shikuam për disa minuta. Atëherë, pa një e pa dy iu hodhëm sipëri njëri-tjetrit dhe filluam të putheshim... U puthëm një kohë të gjatë, aq sa puthja na e shpëtoi lidhjen tonë...

ARMENITA, 35 VJEÇE, NGA PRISHTINA: KURRË NUK KAM PASUR PUTHJE SI AJO NË SHI!

- Njerëzit shijojnë miliona puthje gjatë jetës, por ja që një puthje do u mbes gjatë në jetë, nëse ajo është e veçantë. Tash jam 35 vjeçe, por kurrë nuk mund ta harroj një puthje për një ditëlindje në kohën kur isha në studime. Atë natë, teksa kthehesha me një shoqe time nga

një ditëlindje, filloi të binte shi. U lagëm shumë, u bëmë qull. I dashuri im ishte me mua, më shtrëngoi për trupi dhe me afsh më puthi, aq sa buzët e tij pikonin mbi gojën time nga shiu i rrëmbyeshëm...

ARANITA, STUDENTE E LETËRSISË: PUTHJA NUK ËSHTË ART QË MËSOHET, AJO VJEN VETË

- Puthja është një forcë që vjen nga brenda. Me rëndësi është sa ajo është emocionuese. Megjithatë, mendoj se shqiptarët pak i kushtojnë rëndësi puthjes, karshi popujve tjerë, bie fjala, francezëve, italianëve etj. Jam e mendimit se shqiptarët pak dinë të puthin, sepse nuk janë romantikë sa duhet. Andaj, edhe përjetimet janë të zbehta dhe pa ndonjë veçori të veçantë që ta kujtosh tërë jetën...

SI TA PËRMBYLLIM KËTË SHKRIM?

Puthja është një kënaqësi e rëndësishme e jetës sonë. E, për t'u arritur kulmi i shijes së puthjes, si mashkulli ashtu edhe femra duhet të ndjehen mirë pranë njëri-tjetrit. Dhe, mbi të gjitha, duhet të ndihen të dashuruar, madje shumë.

Diturie Haxhaj

Pse vjehrrës sime i pengon që lahem çdo ditë?

Ndoshta nuk do të isha siç jam sot, vjehrra nuk do mund të luante me mua, por unë atëherë isha shumë e re dhe e padjallëzuar. Mendoja se burri që më donte nuk do ta dëgjonte nënën e vet, por do ta merrte edhe mendimin tim. Por, kjo nuk ndodhi kurrë...

Isha e re dhe plot energji. Atëherë nuk e dija se jeta mund të sillte të papritura. Isha e padjallëzuar, andaj edhe mendoja se edhe ata që më rrethonin ishin si unë.

Ëndërroja se një ditë do të marto-hesha me një djalë të mirë, do të lindja fëmijë dhe do jem e lumtur me familje. Por, ato ishin, thjesht, ëndrrat e mia të bukura...

Kurrë nuk do të kisha besuar se të tjerët mund të ta shkatërrojnë jetën, pa u pasur faj asgjë...

Jam rritur në një familje që nuk di ç'është xhelozia. Prindërit e mi, edhe pse të varfër, na kanë mësuar se si të jetojmë ndershëm, të mos gënjejmë dhe të mos luajmë me ndjenjat e të tjerëve. Edhe pse këto veti janë të mira, tash ata i urrej, sepse po të dija të dridhja e të zhdridhja, s'do të kishte mundësi që vjehrra t'ma shkatërroj martesën...

VJEHRRJA MË SOLLI BUZË VDEKJES

Nuk kisha më shumë se 19 vjet kur takova Ardin. Duheshim dhe mendonim se çdo gjë do të jetë në jetën tonë. Duke menduar vazhdimisht se ishim lindur për njëri-tjetrin, nuk menduam

gjatë: u fejuam dhe pas një kohe të shkurtër edhe bëmë dasmë të madhe. Në fillim të martesës çdo gjë shkonte për mrekulli. Ishim tej mase të lumtur. Pas një kohe mbeta shtatzënë, edhe pse nuk kishim biseduar që të bëhemi me fëmijë. Por, ndodhi dhe nuk na u prish qejfi aspak. Përkundrazi, gëzimi i Ardit ishte shumë i madh.

Ndërkohë, vjehrra ime, burri i së cilës kishte vdekur shumë kohë para martesës sonë, filloi t'i bëjë disa skena të çuditshme. Kur hyja të lahesha thoshte si nuk të vjen marre që hyn të laheshe e të gjithë e dinë pse laheshe... Sidoqoftë, nuk doja ta prishja rehatinë time me burrë dhe asnjë fjalë nuk i thosha për keqtrajtimet që m'i bënte vjehrra. Në fakt, mendoja se një ditë do të ndalej, prandaj edhe nuk doja të hynte sherri në shtëpi.

BURRI M'U VËRSUL ME GRUSHTE E SHQELMA!

Një ditë u tregova prindërve të mi se vjehrra më sillte telashe, por ata më thanë të mos bëja zë, por të shikoja punën time, të mos i prishja raportet me burrë, sepse, sipas prindërve të mi, pak kishte rëndësi a isha mirë me vjehërra a jo.

Erdhi koha e lindjes dhe linda djalë. Por, në raportet e mia me vjehërr asgjë nuk ndryshoi. Unë heshtja e vjehrra vazhdonte me avazin e vjetër. Një mbrëmje, teksa e prisja në dhomën e gjumit tim burrë, ai, pasi u vonua një kohë, kur erdhi ishte i prishur në fytyrë. Pa folur asnjë fjalë m'u vërsul me grushte e shqelma...

"Ti ja ke ia sjell shpirtin në fyt nënës sime, a?!", më tha.

Gjaku më rrodhi nga hundët, ndërkohë djali ynë qante, edhe pse ishte i vogël dhe nuk dinte se ç'ndodhte ndërmjet nesh.

Të nesërmen në mëngjes më tha të bëhem gati se do më dërgoj te prindërit e mi, kinse nuk kam qenë moti. Kur arritëm, ma mori djalin nga krahu dhe më zbriti nga vetura në prag të derës së oborrit, ku edhe më tha të mos kthehem më te ai...

Babai më luti të mos kthehem më te ai e as të mos e kërkoja kthimin e djalit.

Ndërsa, unë isha në gjendje të bëja gjithçka që të isha pranë djalit tim...

Pas një kohe të shkurtër dëgjova se Ardi ishte martuar. Me këtë e kuptova se më nuk kisha vend në jetën e tij dhe as të shpresoja të kthehesha te ai ndonjëherë.

D. Y.

Pse dashurohem vetëm në burra të martuar?

Nuk jam femër e lazdruar, as me flokë gjithmonë të krehura e me veshje me firmë. Jam e thjeshtë, por kam probleme me dashuri...

Nuk jam e veçantë. Nuk jam më e bukur se ti, më e qeshur, më me humor, apo më e mirë në shtrat dhe nuk dal natën me qëllimin për të sjellë dikë në shtëpi. Nuk jam as gjuetare e pasanikëve. Jam shumë e thjeshtë dhe reale.

Megjithatë, të gjitha lidhjet e mia kanë qenë me meshkuj të martuar. Çudi, a? Nuk di pse unë jam ndryshe dhe tërhiqem vetëm nga ata që janë të "zënë", të martuar?

Dëshira ime për burra të martuar ka

ardhur pas shumë e shumë librash të lexuar dhe pas shumë filmave e serialeve që i kam përcjellë.

Andaj, personalisht, mendoj se filmat dhe librat që i dua aq shumë kanë deformuar mendjen time dhe më kanë bërë të varur me idenë e një romance të madhe, që duhet t'i kapërcejë të gjitha pengesat para se të mund të arrijë "fundin e lumtur".

Ajo që kurrë nuk pushon së më surprizuari është se sa shumë meshkuj janë të gatshëm për të tradhtuar. Dhe, nuk po flas për "gjuetarët", po flas për meshkujt e thjeshtë, ata që e duan gruan e tyre, por me tundimin më të vogël bien pre e mëkatit.

SI U BËRA E DASHURA E NJË MINISTRI?

Dhe, çdo gjë ndodhi para do kohësh, kur iu afrova një personi që më pëlqente, pa ditur se ai ishte i martuar. Ishte shofer në njërin nga ministratë

tona. Pas dy-tre takimeve edhe u gjendëm në njërin nga motelet në periferi të Prishtinës.

Sidoqoftë, ajo që unë dua është se nuk kam dashur kurrë të lëndoj njeri. Megjithatë, ndonjëherë mendoj se jam e mallkuar. Qëkur tradhtova të dashurin në lidhjen time të parë serioze, herë pas herë argëtohem me idenë se karma është ajo që ma bën gjithë këtë dhe qesh me mua, teksa më nxjerrë para vetëm meshkuj "të zënë", të martuar...

Duke lënë shakatë mënjanë, realiteti i të qenit "ajo tjetra" është sa emocionues në fillim, aq dhe zhgënjyes dhe i tmerrshëm kur mendon se gjithmonë do të jesh zgjedhja e tij e dytë, plotësuese, komplementare, por kurrë e para.

Dhe, herët a vonë do të heq dorë nga ky ves, për të mirën time. Por, deri atëherë uroj që dashnori im i radhës mos të jetë pikërisht burri yt...

Sh. A.

Dëgjova një britmë në oborr. Vrapova dhe dola jashtë. Në duart e burrit tim pash revolen drejtuar në dashnorin tim. Ia rrëmbeva nga duart dhe e hodha disa hapa larg. Për fat, s'ishte e mbushur. Dhe, më në fund, u zbulua dashuria jonë. E, unë e kisha tradhtuar 20 vjet tim burrë...

Kur isha në shkollë të mesme, në një mbrëmje me shoqe, u njoha me burrin tim. Në ditëlindjen time të 17 ma dhuroi puthjen e parë, kurse në ditëlindjen time të 18 isha gruaja e tij. E doja dhe mendoja se do më dhuronin një jetë të lumtur e pa brenga, e që më kishte munguar deri atëherë. Por, pas tre vjet martesë, për çudi, burri nisi të largohej gjithnjë e më shumë nga unë. Nisi të dilte me gra të tjera... Nuk i fshihte dashnoret e tij, madje edhe mburrej me "zotësinë" e tij.

SA TE NJË GRUA SA TE TJETRA!

Mund ta merrni me mend si e ndjeja veten kur prej askujt s'kisha ndihmë?! Jetoja në pritje se gjërat do të ndry-

A je tu e ditur se unë qe 20 vjet po të tradhtoj, o burrë?!

shonin me tim burrë dhe ai do më kthehej vetëm mua...

Por, ai vazhdonte me të veten: shkonte herë te njëra e herë te tjetra dhe për mua as që e kishte gajle... E, unë isha përmalluar për fjalë të mira të burrit, për ngrohësi e dashuri... Por, më në fund, këto i gjeta te shoku më i afërt i burrit tim... Unë bëra hapin e parë: i shkrova sms dhe i kërkova të ma dërgonte me video një trëndafil të kuq, nëse dëshironte të kishte lidhje me mua. Nuk prita shumë e ai u bë imi dhe i tillë mbeti 20 vjet. Ishte vështirë për të gjetur vend për t'u takuar, meqë na njihnin. Por, ia dilnim disi... As burri im e as fëmijët nuk dyshonin në mua sa herë që dilja nga shtëpia dhe humbja me orë të tëra... Vitet kalonin e dashuria jonë ishte e pandryshuar. Mund të shkurorëzohesha nga burri e të martoheja me të, sepse ai ishte pa grua, meqë i kishte vdekur vite më parë. Por, më dhimbeshin fëmija, meqë në atë kohë i kisha dy fëmijë.

SI E KËSHILLOVA DASHNORIN QË TË MARTOHEJ?

Dashnorin e këshillova të martohej, sepse ishte i ri dhe kishte nevojë të

krijojë familje, sepse gruaja që i vdiq vite më parë nuk ia lë fëmijë. Ditën e dasmës së tij nuk m'u drodh zemra fare, sepse isha e sigurt se nuk do e humbisja edhe pse martohej, meqë ai marrëzisht më dashuronte... Por, koha ngadalë tinëzisht e ndryshoi dashurinë time. Dashnori im ishte lodhur nga jeta e dyfishtë dhe iu dha pijes. Dhe, atë ditë, kur edhe u zbulua dashuria jonë, ai kishte pirë shumë. Nuk ishte përmbajtur dhe vjen në shtëpinë time. Në derë e pret burri im me revole në dorë. Ia nxora shpejt e shpejt nga dora burrit tim revolen dhe ia hodha disa hapa larg. Fatmirësisht, revolja kishte qenë e zbrastë.

20 VJET TË KAM TRADHTUAR, O BURRË!

Në fund, nuk durova dhe i tregova se 20 vjet e kisha tradhtuar. Për çudi, ai nuk nxori zë nga goja... Pse e bëri një gjë të tillë, as atëherë e as sot nuk e di! Sidoqoftë, kurrë nuk e kam ndie veten fajtore, sepse po t'më donte ai, siç më donte në fillim, kurrë nuk do e tradhtoja...

Th. X.

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depressive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Pandemitë, a paralajmërojnë fundin e botës?

Jam një zonjë nga Gjilani. Kam jetuar në Zvicër, por jam kthyer sërish në Gjilan.

Duke i parë shumë ndryshime që po ndodhin në jetën tonë, dua të di a janë shenja të fundit të botës? Pandemia e ka goditur botën dhe 1 milion jetë i ka marrë deri më tash. Edhe në Saharë po bie borë!

Si i sheh ti këto ndryshime?

“Bora”

Përgjigje:

Ndryshime ka shumë. Kjo është e vërteta gjeografike dhe shoqërore që e kanë goditur planetin tonë.

Prej kur mban mend njerëzimi, në shkretëtira nuk ka rënë borë, kurse vjet ra borë në Saharë e sivjet edhe në shkretëtirën e Algjerisë.

Pra, është diçka e pazakontë... Por, në Kuran flitet për këtë dukuri dhe profeti Muhamed a. s., thotë se fundi i botës do të ndodhë kur shkretëtira e Saharasë do të mbulohet nga gjelbërimi, e rëra ta mbulojë Kullën e Ajfelit.

Çka paraqet numri i fatit?

Përsëndetje, jam një zonjë nga Tirana. Kam dëgjuar se çdo njeri

e ka numrin e vet, por nuk di më shumë për këtë gjë. A është e vërtetë se numri i fatit tregon rrjedhën e jetës së çdo njeriu dhe a mundeni ju ta gjeni atë?

“L., Tiranë”

Përgjigje:

Çdo njeri e ka numrin e fatit.

Numrin e fatit e përcakton data, muaji dhe viti i lindjes.

Një nga dhjetë numrat ekzistues të fatit i posedon çdo njeri dhe konform tij çdo kush e ka një karakter të pandryshuar. Ka një botë të pandryshuar dhe një grup gjaku konstant, mbi të cilin lindet dhe ushqehet shpirti deri ta braktisë trupin.

Numri i fatit tregon kush je, ç'bën dhe nga po u qon jeta, si dhe atë që mund ta ndryshoni me sjelljen dhe mendjen tuaj.

Numri i fatit jep karakterin e çdo njeriu, duke iu ndihmuar në dashuri, martesë dhe në reduktimin e gabimeve që mund t'i bëjë njeriu pa dashje dhe sipas valëve të jetës.

A do të martohem me njeriun që e dua?

Përsëndetje, jam një vajzë 28-vjeçare, nga Prishtina. Jam në lidhje disa vjet me një djalë për të cilin e di familja ime dhe e tij.

Herë pas herë fjalosemi, sepse nuk po e bën punën të fejuhemi dhe kjo po më shqetëson shumë. Po ikë prej meje, ndërkohë më thotë se nuk mundet pa mua. (Mos i boto emrat dhe të dhënat e tjera, të lutem...).

Çka do të ndodhë me ne?

“E harruara”

Përgjigje:

E vërtetë është se ai të do. Por, ka momente që të do tepër, e ka momente që i degradon dashuria për ty.

Ju do të ndaheni kah muaji mars. Ai do të fejohet në shpejtësi dhe pas 3-4 muajsh do të ndahet dhe do të rifillojë përsëri me ty...

A janë magji sendet që i gjeta në dhomën time?

Jam e martuar që tre muaj, pa dasmë shkak i pandemisë. Me personin tim, e që tani e kam burrë, kemi kaluar mirë. Mezi kemi pritur të bashkohemi...

Por, një ditë, në ormanin tim, në dhomë kam gjetur një mbështjellje - pallomë me gjak dhe disa gjilpëra në pallomë. Kishte edhe flokë e thonj dhe plumb i shkrirë.

Të lutem, a do të ndodhë diçka e keqe?

“Pa shifër”

Përgjigje:

Saktë, janë magji. Janë vendosur aty për ndarje. Largoni nga dhoma dhe digjni jashtë oborrit të shtëpisë!

Në familjen e burrit ka nisur të krijohet një atmosferë kundër teje dhe ti e sheh çdo ditë vetë se diçka po ndodhë kundër teje... Por, rehatia do të kthehet gradualisht...



SHERWOOD

Resorts and Hotels

Feel the Legend

**SHERWOOD
EXCLUSIVE KEMER**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
EXCLUSIVE LARA**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
DREAMS RESORT**
BELEK / ANTALYA

**TUI BLUE
BELEK**
BELEK / ANTALYA

**SHERWOOD
SUITES RESORT**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
GREENWOOD RESORT**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
PRIZE HOTEL**
LARA / ANTALYA



+90 242 444 88 07
www.sherwoodhotels.com.tr

